

**THEORY OF RECEPTION AND CRITICISM OF FILMS BASED ON
THE RECEPTION AND CRITICISM OF THE FILM “ANNA
KARENINA” (1997)**

**TEORIA E PRITJES DHE KRITIKËS SË FILMAVE BAZUAR NË
PRITJEN DHE KRITIKËN E FILMIT “ANNA KARENINA” (1997)**

Ajmon SALIHU¹

¹ PhD in Film & Tv Directing in Faculty of Dramatic Arts „Ss. Cyril and Methodius“ - Skopje

^{}Corresponding author e-mail: ajmonesumajsalihu@gmail.com*

Abstract

The word reception means the acceptance of foreign ideas, norms and values or behaviors. Reception history elaborates the reception that a literary text, a film, or in this case an adaptation of a novel, has found in its audience over time. This paper delves into the core concepts of film reception theory, shedding light on how audiences interpret and actively engage with cinematic narratives. The theoretical part includes different perspectives, recognizing that audience responses are shaped by individual experiences, cultural contexts, and societal influences. This study also delves into the concept of criticism, whether that from the audience or from theorists and critics. This study after the theoretical part of the reception elaborates the reception and criticism of the film *Anna Karenina* (1997) directed by Bernard Rose. As an adaptation of the novel *Anna Karenina* by Leo Tolstoy (1887), criticism and reception in this case focuses, among other things, on the stallings and deviations of the adapted story.

Additionally this paper addresses the evolving landscape of film reception in the digital age, considering the impact of online communities, social media and interactive platforms on audience engagement. This study aims to contribute to the ongoing discourse on film reception theory by providing insights into the multifaceted nature of audience engagement and its implications for the wider field of film studies. During this study, I came to the conclusion that coded messages and pre-existing expectations also influence the audience's reception of a film. The coded message is deciphered by the audience based on the knowledge they possess and not the way the producer thought. In this case, the producer too should not convey messages that are not easily decoded by the audience.

Keywords: Audience, Reception, Film.

1. Hyrje

Teoria e pritjes dhe kritikës së filmave, shqyrton marrëdhënien dinamike në mes të filmave dhe pritjes së tyre nga audiencia dhe kritika. Ky kërkim fillon duke përshkruar parimet themelore të teorisë së pritjes së filmit. Teoria parashtron pritjet dhe ndikimet kulturore të audiencës të cilat formësojnë ndjeshëm pritjen dhe interpretimin e tyre për një film, duke nënvizuar ndikimin e thellë që pritjet e audiencës kanë në përvojën kinematografike. Ndërsa kritikët janë zëra të pavarur, pritshmëritë e audiencës mund të ndikojnë indirekt në vlerësimet.

Nëse një film devijon ndjeshëm nga ajo që pret audiencia e synuar, mund të ndikojë në pritjen kritike. Kritikët shpesh marrin parasysh qëllimet e regjisorit dhe nëse ato synime komunikohen në mënyrë efektive përmes filmit. Derisa kritikët synojnë të ofrojnë vlerësime objektive, në anën tjetër opinionet individuale mund të ndryshojnë dhe paragjykimet personale mund të hyjnë në lojë. Marrëdhënia midis kritikëve dhe pritjeve të audiencës është komplekse; kritikët mund të ofrojnë njohuri që rezonojnë ose sfidojnë pritshmëritë e audiencës, duke ndikuar në pritjen e përgjithshme të një filmi.

Derisa kritikët shpesh vlerësojnë meritën artistike të një filmi, duke marrë parasysh elementë të tillë si regjia, kinematografia, skenari, aktrimi dhe mjeshtëria e përgjithshme. Ndërsa preferencat dhe opinionet individuale të audiencës ndryshojnë, dhe ajo që tërheq një person mund të mos rezonojë me një tjetër. Përveç kësaj, faktorë të jashtëm si klima socio-politike dhe konteksti kulturor mund të luajnë gjithashtu një rol në formësimin e pritjes së audiencës.

Në pritjen e një filmi rol të rëndësishëm luan edhe marketingu dhe publiciteti, si dhe narrativa terheqëse. Pritja dhe Kritika e një filmi është poaq dinamike kur filmi është adaptim i një romani të njohur. Ky punim shqyrton edhe këtë çështje, duke bërë një analizë të thukët të pritjes dhe kritikës së filmit “Anna Karenina” (1997) me regji të Bernard Rose. Që është realizuar si adaptim i romani “Anna Karenina” nga Leo Tolstoi. Libri u botua në vitin 1887 duke nxjerrë në pah problemet shoqërore dhe institucionale të Rusisë cariste, përmes tri familjeve apo tri linjave të romanit.

Regjisoret e Filmave që adaptuan këtë roman, shpresuan se filmat e tyre do bashkë me romanin do adaptonin edhe interesimin e audiencës dhe namini që pati libri në mbarë botën. Është e vërtetë që filmat “Anna Karenina” tërhoqën audiencën por pa mundur të nxjerrin në pah vlerat e romanit. Ekranizimet e këtij romani kanë filluar qysh në shekullin XIX kur filmi ishte pa zë. Që atëherë shumë regjisorë sfiduan vetën në adaptimin e këtij romani. Njeri ndër ta ishte edhe regjisori Bernard Rose. Me filmin Anna Karenina (1997), natyrisht që si çdo film i ri edhe ky film duke pas parasysh që ishte një adaptim i romanit të njohur, u përball me lëvdata dhe kritika si nga audiencia ashtu edhe nga teoricienët e filmit.

Në këtë punim përpos elaborimit të teorisë së pritjes dhe një analize koncize të pritjes së filmit Anna Karenina (1997), duke u mbështetur në teoritë ekzistuese do të gjejë se cilët faktorë ndikojnë në pritjen një filmi nga audiencia? Ndërsa duke hulumtuar të dhënat në pritjen e filmit Anna Karenina (1997) do të gjejë sesi u pritë ky film nga audiencia dhe kritikët e filmit, gjithë këtë për tu përgjigjur gjithashtu në hipotezat e ngritura dhe pyetjet kërkimore.

1.1. Problemet e hulumtimit: Duke vërejtur se ka një disbalancë mes kodimit të mesazheve nga prodhuesi dhe dekodimit të mesazheve nga audiencia, do të përmbledh mendime dhe sugjerime të teoricienëve të njohur në fushën e teorisë së Pritjes, për të nxjerrë në pah problemet me të cilat përballtet audiencia gjatë deshifrimit të mesazheve. Si dhe çfarë ndikon në mënyrën e leximit të mesazhit. Gjithashtu duke parë se filmat që adaptojnë romane klasike gjithnjë e më shumë sikur e dëshpërojnë pritjen e audiencës, më ka ngacmuar fakti për të gjetur se ku qëndron problemi. A janë të interesuar producentët dhe regjisorët vetëm për namini e romanit që adaptojnë, apo për storien e përshkruar në roman. Si ndikon kjo në pritjen e filmit nga audiencia dhe vlerësimin e kritikës.

1.2. Objektivat e Hulumtimit: Qëllimi i këtij punimi është që duke konsultuar hulumtime të mëhershme në teorinë e pritjes të vë në pah faktorët objektiv dhe subjektiv të cilët ndikojnë në mënyrën sesi audiencia do t'i perceptojë filmat. Çfarë mund të bëhet në të ardhmen që audiencia të arrijë të deshifroj mesazhet ashtu si i ka menduar prodhuesi? Përveç kësaj, në rastin konkret do mundohem të gjejë sesi është pritur filmi “Anna Karenina” (1997). Me qëllim që të identifikoj reagimet dhe interpretimet e mundshme të audiencës, për të gjetur sesi e kishte vlerësuar Audiencia këtë film? Si e kishin vlerësuar teoriticienët dhe kritikët e filmit, këtë film. A ka pasur dallime në vlerësim mes audiencës që ka lexuar romanin “Anna Karenina” dhe atyre që nuk e kanë lexuar.

1.3. Pyetjet kërkimore – Hipotezat:

1. A ka ndikim kritika në pritjen e një filmi nga audiencia?
2. Sa kanë ndikim mesazhet e koduara dhe gjuha filmike në pritjen e një filmi nga audiencia?
3. Si ndikojnë pritjet para-ekzistuese të audiencës të formuara nga marketingu apo veprat e mëparshme, në pritjen dhe kritikën e një filmi?

1.4. Metodologjia e Hulumtimit / Qasja metodologjike: Në diskutimin teorik do të mbledh të dhëna se çfarë ndikon në pritje e një filmi. Pastaj do të përmbledh mendime dhe sugjerime të kritikëve për të nxjerrë në pah se cilat janë faktorët objektiv si dhe ata subjektiv që ndikojnë në pritjen e një filmi. Gjithmonë duke iu referuar teoriticienëve të pritjes së filmit do mundohem të nxjerrë në pah sesi duhet ta kodojnë prodhuesit mesazhin, në mënyrë që audiencia të arrijë ta deshifrojë më lehtë. Përveç kësaj gjatë këtij studimi do mundohem të mbledhë të dhëna sesi është pritur filmi “Anna Karenina” (1997). Duke qenë se ky film është adaptim i romanit “Anna Karenina” do të gjej sesi ka ndikuar kjo në vlerësimin e audiencës dhe kritikës. A u krahasua nga kritika ky film me romanin apo u vlerësua edhe në bazë të vlerave artistike. Gjithashtu do mundohem të gjejë nëse kishte dallime në vlerësimin e audiencës që kishin lexuar librin dhe të atyre që nuk kishin lexuar librin.

1.5. Metodatat e Hulumtimit: Gjatë këtij studimi do të mbështetem në këto metoda:

1. Metodatat e përdorimit të literaturës shkencore.
2. Metodatat krahasuese.
3. Metodatat e Analizës dhe sintezës.

Duke shqyrtuar literaturën shkencore do të laboroj problemet me të cilat përballet audiencia në pritjen e një filmi për të krahasuar pastaj pritjen e audiencës dhe të kritikës. Ndërsa sa i përket pritjes së filmit “Anna Karenina” (1997), lidhje me pritjen e këtij filmi nga kritika përpos metodave të lartcekura do t'i referohem edhe metodës së analizës dhe sintezës. Meqenëse ky film është shfaqur në vitin 1997, në pamundësi të intervistimit të drejtë për drejtë të audiencës, do tu referohem, mjeteve të informimit dhe gazetave elektronike që të mund të paraqes një pasqyrë sesi është pritur ky film nga audiencia.

2. Diskutimi teorik

2.1. Teoria e pritjes: Teoria e pritjes merret me problemin e të kuptuarit të teksteve mediatike, ne veçanti me studimin sesi këto tekste lexohen nga audiencia në një moment të caktuar historik. Teoria e pritjes mundohet të përmbledhë të gjithë faktorët objektiv dhe subjektiv, të cilët ndikojnë në mënyrën sesi audiencia do të ndërvepron me filmat apo t'i percepton filmat. Teoriticienti Hans Robert Jauss i referohet një zbatimi historik të teorisë së përgjigjes së lexuesit ndaj një teksti.

Sipas tij pritja e një teksti nuk duhet të vlerësohet në leximin e parë, por duhet t'i jipet distancë kohore në leximin e dytë. duke theksuar ndryshimin e pritjes apo leximit të një teksti nga brezat e lexuesve. “Në të njëjtën kohë, ai duhet të sjellë në pah distancën e përkohshme që është kapërcyer në fazën e parë dhe të dytë të leximeve tona dhe të lejojë që dikush të dallojë përmes ndarjes së qartë të horizontit të së shkuarës dhe së tashmes, për të kuptuar se si ka kuptimi i poezisë është shpalosur historikisht në ndërveprimin midis efektit dhe receptimit deri në ato pyetje që drejtojnë interpretimin tonë dhe për të cilat teksti në kohën e vet nuk duhej të ishte ende përgjigja.”¹ - Jauss për të përcaktuar kornizën e pritjeve që bashkojnë autorët dhe lexuesit në konsultimin dhe interpretimin e teksteve, përdorë termin filozofik “horizonti i pritjeve” “Interpretimi historik i tekstit tonë ka çuar kështu në një rindërtim të kundërvënive të tij brenda horizontit të pritjeve të poezisë romantike, një rindërtim që tani duhet të sigurohet përmes metodës hermeneutike të zgjerimit të kontekstit.”²

Sipas pasus veprat nuk mund të konsiderohen si universale, ato nuk mund të përçojnë mesazhin e njëjtë apo të ndikojnë njëjtë tek lexuesit e të gjitha epokave. Mirëpo sipas disa teoriticientëve, mënyra më e mirë në studimet e pritjes, është intervistimi i audiencës, për të mbledhur mendimet e tyre, edhe pse individët ndonjëherë mund të mos jenë në gjendje të interpretojnë një film në një mënyrë të veçantë. Gjatë hulumtimit të pritjes së filmave të vjetër studiuesit hasin në probleme edhe të natyrës tjetër, shpesh ata e kanë të pamundur të intervistojnë individ që kanë parë filmat klasik gjatë lansimit të tyre fillestar.

Atëherë studiuesit janë të detyruar tu drejtohen burimeve tjera siç janë mediat elektronike për të mësuar sesi është pritur një film i caktuar. Pra rishikimet mund të japin një ide sesi audiencia dhe kritika e kishte pritur një film. Duhet pasur parasysh se studiuesi asnjëherë nuk mund të bazohet në opinionet e një kritiku, ngaqë ato mund të mos përfaqësojnë një pjesë të audiencës. Për të krijuar një përshtypje sesi mund të jetë pritur një film klasikë duhet të përdoret material nga shtypi, industria e filmit etj. “Një analizë e pritjes së një filmi do të përdorë të gjitha këto metoda për të arritur një kuptim sesi audiencia e interpretoi dhe e kuptoi tekstin”³

Shumë teoriticientë të teorisë së pritjes theksojnë se është e pamundur të mësosh reagimin e secilit shikues ndaj një filmi të caktuar. Duke u nisur nga fakti se të gjithë njerëzit posedojnë identitete të shumta subjektive, duke përfshirë moshën, gjininë, kombësinë, besimin fetar, përkatësinë etnike etj. Përveç kësaj audiencia është e ndikuar edhe nga rrethana socio – ekonomike dhe politike. Në vlerësimin e një filmi shpesh ndikon edhe disponimi i shikuesit në çastin kur është duke parë filmin, si dhe rrethana tjera subjektive. “Mënyra sesi spektatori e përkufizon vetën si person dhe si anëtar i një shoqërie me të madhe ndikon në mënyrën sesi ai ose ajo do ta shohë një film. Për shembull, nëse një film ka një mesazh të fortë feminist, ka të ngjarë që të shihet ndryshe nga një person që e konsideron veten feministe, sesa nga një person që nuk e konsideron vetën të tillë.”⁴

Mendoj se nëse një film nxjerrë në pah të metat e shtetit, ndryshe do të pritet nga audiencia e atij vendi dhe ndryshe nga audiencia e vendeve tjera. Në pritjen e një filmi rol të rëndësishëm luan kutura dhe përkatësia fetare. Besimet fetare dhe vlerat morale mund të ndikojnë në mënyrën se si perceptohet një film, veçanërisht nëse filmi trajton ose sfidon këto vlera. Ndërsa kur filmi është përshtatje e një romani, ndikon edhe një faktorë tjetër në pritjen e tij nga audiencia dhe kritika. Filmi i tillë ndryshe perceptohet nga audiencia që ka lexuar romanin dhe ndryshe nga audiencia që nuk ka lexuar romanin.

¹ Hans Robert Jauss, *Toward an Aesthetic of Reception*. Translated by Timothy Bahti. (Minneapolis: University of Minnesota Press, 1982), 170.

² Hans Robert Jauss, *Toward an Aesthetic of Reception*. Translated by Timothy Bahti. (Minneapolis: University of Minnesota Press, 1982), 175.

³ Reception Theory: Methodology.” Film Reference. <http://www.filmreference.com/encyclopedia/Independent-Film-Road-Movies/Reception-Theory-METHODOLOGY.html> (last accessed 12/02/2022)

⁴ Ibid.

Irena Makoveeva në punimin e saj “Cinematic Adaptations of Anna Karenina”, lidhje me pritjen e një filmi bazuar në roman shprehet: “Për shembull, një audiencë e njohur me komplotin origjinal lexon ndryshe filmin sesa një audiencë injorante, për shkak se e para sjellë me vete imazhe të paracaktuara bazuar në tekstin verbal.”⁵ Pra ngaqë në këtë rast derisa ka qenë duke lexuar librin ka krijuar imazhe në mendjen e tij, të cilat ka pritur t’i sheh edhe në film.

2.2. *Kodimi dhe leximi i mesazheve*: Mesazhet e koduara përmbajnë shenja dhe simbole të përbashkëta për të gjithë spektatorët. Leximi i mesazheve nga audiencia bëhet në bazë të ndërveprimit të tyre me tekstet në kontekste specifike për të krijuar kuptime. Kuptimi i mesazhit nga audiencia, mund të ndryshoj, sipas kontestit të tyre shoqëror, në mënyrën si ata e shohin të përshtatshëm. Janet Staiger në punimin e saj “Film, Reception and Cultural Studies” duke iu referuar autorëve Brunson dhe Murley (1978), ndër të tjera thotë: “... audiencia nuk do të lexojë gjithmonë një mesazh ‘drejtë’”⁶.

Ndërsa Teoriticianti Stuart Hall në punimin e tij “Kodimi dhe dekodimi në diskursin televizional”(1973) sqaroi në mënyrë të detajuar sesi prodhuesit e kodojnë kuptimin e një teksti, i cili tekst më pas do të deshifrohet nga audiencia në bazë të njohurive që posedon ajo audiencë, Por sipas tij shpesh audiencia deshifron apo dekodon mesazhin në mënyra të ndryshme, dhe jo në mënyrën si ka menduar prodhuesi. Hall argumenton se edhe strukturat e transmetimit duhet të kenë kujdes që mesazhin e koduar ta japin në formën e një diskursi kuptimplotë. “Përpara se ky mesazh të mund të ketë një efekt (sidë që të përcaktohet) ose të plotësojë një ‘nevojë’ ose të vihet në një ‘përdorim’, ai fillimisht duhet të perceptohet si një ligjërim kuptimplotë dhe të dekodohet në mënyrë kuptimplotë”⁷.

Ai sqaroi në vazhdim se grupi i kuptimeve të dekoduar duhet të jenë kuptime që kanë efekt, pra që ndikojnë të lexuesi apo shikuesi që i argëtojnë ata, i udhëzojnë ose i bindin me pasojat komplekse, perceptuese, emocionale, njohëse, ideologjike etj. Ndërsa David Morley and Charlotte Brunson në librin “The Nationwide Television Studies” pasi theksojnë se do të ketë çdo herë lexime individuale dhe private, sugjerojnë që studiuesit nuk duhen të merren me dallimet individuale të interpretimit, në vend të kësaj ata duhet të hetojnë shkallën në të cilën këto lexime individuale janë modeluar në struktura dhe grupime kulturore.

“Ajo që nevojitet këtu është një çasje që lidh interpretimet diferenciale me strukturën socio – ekonomike të shoqërisë, duke treguar sesi anëtarët e grupeve dhe klasave të ndryshme, që ndajnë ‘kode kulturore’ të ndryshme, do ta interpretojnë një mesazh të caktuar ndryshe, jo vetëm në nivelin personal, idiosinkratik, por në një farë mënyre ‘të lidhur sistematikisht’ me pozicionin e tyre socio-ekonomik.”⁸ Konteksti kulturor formon mënyrën se si audiencia lidhet me mjedisin, personazhet dhe referencat kulturore të filmit. Një film i rrënjësor thellë në një kulturë të caktuar mund të rezonojë fuqishëm me audiencën e njohur me atë kulturë, ndërkohë që është më pak i arritshëm për të tjerët.

Përfaqësimi i racës dhe përkatësisë etnike në film mund të ndikojë në pritjen e tij, veçanërisht në shoqëritë ku çështjet racore dhe etnike janë të spikatura. Ella Shohat dhe Robert Stam në librin e tyre: “Unthinking Eurocentrism: Multiculturalism and Media” diskutojnë se si faktorët kulturorë ndikojnë në pritjen e filmit: “Vetë perceptimi është i ngulitur në histori. Të njejtat imazhe filmike ose tinguj, provokojnë jehonë të dallushme për komunitete të ndryshme.

⁵ Makoveeva, Irena. “Cinematic Adaptations of Anna Karenina.” *Studies in Slavic Cultures*, no.2 (2001): 2.

⁶ Staiger, Janet. “Film, Reception, and Cultural Studies” *The Centennial Review* 36, No.1 (1992): 94.

⁷ Stuart Hall, “Encoding and Decoding In The Television Discourse”, *Council & The Centre for Mass Communication Research, University of Leicester*, (1973): 3.

⁸ David Morley and Charlotte Brunson. *The Nationwide Television Studies* (London: Routledge, 2005), 134.

Për euroamerikanin, pamjet e malit Rushmore (për shembull, në *North by Northwest*) mund të ngjallin kujtime të dashura të figurave atdhetare patriotike; për amerikanët vendas ata mund të ngjallin ndjenja të shpronësimit dhe padrejtësisë.⁹ Ky citim nxjerr në pah argumentin e autorëve se receptimi i filmit ndikohet në thelb nga konteksti kulturor dhe social i shikuesit. Ata po në këtë libër eksplorojnë se si faktorët kulturor dhe ideologjik formojnë interpretimin dhe receptimin e medias. Ata përveç pritjes dhe perceptimit ndryshe të filmit në bazë të kulturës së audiencës, mbi këtë bazë arsyetojnë edhe reagimin e audiencës.

“Por të shohësh botën përmes thjerrëzave të ofruara nga kultura e dikujt nuk është domosdoshmërisht raciste, nuk është raciste as të vëresh dallime fizike ose kulturore, ose të urresh anëtarët e caktuar të një grupi, apo edhe të mos pëlqesh tiparet kulturore të grupeve të veçanta.”¹⁰ Ata argumentojnë se subjekti i shikimit nuk është kurrë jashtë ideologjisë, kurrë përtej pozicionimit kulturor, kështu që çdo lexim i një filmi ndërmjetësohet nga pozicioni shoqëror i shikuesit, konteksti historik dhe përvojat kulturore. Faktorët social-kulturorë që ndikojnë në pritjen dhe kritikën e një filmi janë të shumanshëm dhe të ndërthurur. Diskutimet rreth këtyre faktorëve janë thelbësore për të kuptuar se si filmat rezonojnë me audiencën të ndryshme dhe se si kontekstet kulturore, sociale dhe politike formojnë përvojat kinematografike. Këto diskutime theksojnë gjithashtu rëndësinë e diversitetit. Reagimet e ndryshme ndaj filmave janë simptoma të përvojave të ndryshme historike dhe Dëshirave sociale¹¹

Shohat dhe Stam shtjellojnë më tej idenë se si krijimi ashtu edhe pritja e filmave ndikohen nga kontekstet kulturore dhe politike. Një teoricien i shquar që thekson rolin e kulturës në pritjen e një filmi është Stuart Hall. Puna e Hall në studimet kulturore, veçanërisht teoria e tij e kodimit dhe dekodimit në media, eksploron se si konteksti kulturor formon mënyrën se si audiencën interpreton dhe kupton tekstet mediatike, duke përfshirë filmat. Ndërsa Hall në punimin e tij sqaroi shenjat e mesazheve vizuale.

Ai argumentoi se shenjat e një mesazhi vizual zakonisht janë arbitrare dhe ikonike. Sipas tij shenjat vizive mund të shkaktojnë më pak keqkuptime se ato gjuhësore, por me kusht që të jepet mjaft informacion pra të jenë të plota. Në anën tjetër ai argumenton se: “Është gjithashtu e vërtetë se shenja ikonike mund të mbështesë ‘lexime të gabuara’, thjesht sepse është kaq ‘natyrore’, kaq ‘transparente’.”¹²

Hall më tutje sqaron se gabimet mund të lindin jo ngaqë shikuesit nuk mund të deshifrojnë fjalë për fjalë shenjën por ngaqë shikuesit janë të tunduar nga natyralizmi i shenjës. Hill në lidhje me kuptimin e leximit të shenjave i referohet teoricitit Dr. Terni (1973) “Me fjalën lexim nënkuptojmë jo vetëm aftësinë për të identifikuar dhe deshifruar një numër të caktuar shenjash, por edhe aftësinë subjektive për t’i vënë ato në një marrëdhënie krijuese midis tyre dhe me shenjat e tjera”¹³

Hall përcaktoi tri forma të leximit që mund të marr audiencën gjatë deshifimit të leximit. 1. Lexim Dominues. 2 Lexim Kundërshtues. 3 Lexim të Negociuar. Ai sqaroi se audiencën do të marr lexim dominues, kur mesazhet janë të qarta. Ndërsa kundërshtues atëherë kur audiencën refuzon leximin e preferuar dhe krijon kuptimin e vet. Ndërsa lexim të negociuar merr atëherë kur audiencën pranon disa pikëpamje të producentit, por njëkohësisht ka edhe pikëpamjet e veta. Hall u referohet disa faktorëve të cilët ndikojnë se çfarë nga këto tri lexime do të marr audiencën.

⁹ Shohat, Ella, and Robert Stam. *Unthinking Eurocentrism: Multiculturalism and the Media*. 2nd ed. New York: Routledge, 2014, 353.

¹⁰ Ibid, 22.

¹¹ Ibid, 353.

¹² Stuart Hall, “Encoding and Decoding In The Television Discourse”, Council & The Centre for Mass Communication Research, University of Leicester, (1973): 12.

¹³ Stuart Hall, “Encoding and Decoding In The Television Discourse”, Council & The Centre for Mass Communication Research, University of Leicester, (1973): 14.

Mosha, Besimet, kultura, gjinia, përvoja e jetës, humori në momentin e shikimit. Përveç tjerash teoritë e Hall janë të rëndësishme për të kuptuar se si prejardhje të ndryshme socio-kulturore ndikojnë në pritjen e një filmi. Puna e tij thekson se një film nuk pranohet në mënyrë pasive nga një audiencë homogjene, por interpretohet në mënyrë aktive nga shikues të ndryshëm, të cilët sjellin kornizat e tyre kulturore në përvojën e tyre të shikimit. Përveç këtyre që u cekën më lartë pritja e një vepre artistike në këtë rast e një filmi varet shumë edhe nga reklamat që i bëhen atij filmi para se të shfaqet. Teoriticienët dhe kritikët e artit krijojnë opinionin e tyre të pavarur nga opinionet dhe reklamat. Por këto padyshim që mund të kenë ndikim në masë.

Nëse një film vlerësohet paraprakisht nga kritikë të njohur, audienca duke mos e kuptuar konceptin e posedimit të një pikëpamje individuale për një film, imponueshëm do ta pëlqejë atë film. Në këtë rast spektatori nga frika e reflektimit si injorant, vlerëson filmin jo nga shija personale, por nga opinionet e kritikëve dhe reklamave. Ndërsa sa i përket dekodimit të mesazheve nga audienca, mendoj se përveç faktorëve që u përmendën më lartë, leximi i mesazheve varet edhe nga shkalla e kulturës, apo njohurive në fushën e artit, rrjedhimisht nga të kuptuarit e shenjave semiotike, arbitrare dhe ikonike, që marrin funksionin e simbolit në mesazhet vizive. Në fund është me interes të ceket se filmat që kanë adaptuar një roman, përveç që priten më me interes nga audienca, ajo është e prirur të krijojë opinionet personale bazuar në romanin që kanë lexuar paraprakisht, pa u ndikuar nga reklamat dhe opinionet e kritikës së filmit.

3. Pritja e filmit “Anna Karenina” (1997)

3.1. Vlerësimi i audiences: Meqë ky film është shfaqur vite me parë, është e pa mundur të intervistohet audienca. Andaj duke u mbështetur në burime të mjeteve të informimit dhe gazetave elektronike do mundohem të paraqes një pasqyrë sesi është pritur ky film nga audienca. Filmi “Anna Karenina” (1997) është adaptim i romanit me të njëjtin emër të shkruar nga Leo Tolstoi në vitin 1887. Ky film ashtu si filmat e më hershëm “Anna Karenina” që i referohen të njëjtit roman, ka zgjuar një interesim të madh tek audienca. Kur filmi është adaptim i një romani siç është rasti me filmin në fjalë, ndryshe do të jetë pritur nga audienca që kishin lexuar romanin me parë, dhe ndryshe nga ata që nuk e kanë lexuar.

Por duke u bazuar në bujën që kishte bërë ky roman, duke u përkthyer në të gjitha gjuhët e botës, i cili edhe sot lexohet me endje, mund të ketë përqindje të vogël të audiencës që nuk e kanë lexuar romanin me parë. Duke iu referuar ueb faqes “Rotten Tomatoes” e cila përveçse publikon mendimet e kritikëve të filmit ajo u mundëson edhe audiencës që të regjistrohen dhe të japin vlerësimet dhe shprehjen e mendimit të tyre. Në këtë ueb faqe për filmin “Anna Karenina” (1997) japin vlerësimet e tyre rreth 2500 përdorues.

Ku mesatarja e këtyre vlerësimeve ka rezultuar të jetë 66% në dobi të filmit. Gjatë leximit të te dhënave që ofron kam parë me vëmendje shqyrtimet e audiencës, ato ishin nga me të ndryshmet. Audienca zakonisht ankohej për aktoren kryesore, që sipas tyre duket e ftohtë, pastaj për dialogun mediokër në film. Dikush kishte pëlqyer sytë e trishtuar të Sophie Marceau, disa të tjerë pëlqyen aktoren Sophie Marceau në tërësi. Dikush nuk ishte i kënaqur me intensitetin e dashurisë së treguar në film mes Annës dhe Vronskit. Disa nuk ishin të kënaqur me zhvillimin e linjave dytësore të tregimit etj. Disa që nuk kishin lexuar më parë romanin, pëlqyen fimin aq sa u inspiruan të lexonin edhe romanin. Në vazhdim do të paraqes disa nga vlerësimet e shumta të audiencës duke iu referuar kësaj faqeje.

Alisha A , 08.06.2009

“Ishte mirë, por ndjeva se deri në fund redaktimi e bëri atë pak të turbullt”.

Pasqyrë .10 maj 2010

“Thjesht e perkryer !!!!!!!!!!!!!!!” (pesë nga pesë yjet)

Mayra R 03 prill 2010

“Më pëlqen filmi...Dua ta lexoj librin tani” (tre e gjysmë nga pesë yjet)

Rob L 19 mars 2010

“Kjo ishte shumë e mërzitshme, më pëlqen kjo histori e Tolstoit, por kjo nuk ishte një përshtatje e shkëlqyer e saj” (dy nga pesë yjet)

Këto ishin disa nga vlerësimet e marra nga ueb faqja “Rotten Tomatoes”

Ndërsa ueb faqja IMDb e cila është një bazë e të dhënave në internet në lidhje me filmat, kjo ueb faqe gjithashtu iu mundëson audiencës të regjistrohet për të votuar si dhe për të dhënë vlerësime me shkrim. Në rastin konkret audiencia ka shprehur mendimin dhe ka dhënë vlerësimet me shkrim duke u identifikuar me pseudonim. Në këtë ueb faqe gjithsej votuan (5,863 IMDb users have given a weighted average vote of 6.2 / 10 dhe 47) si dhe dhanë shqyrtimet e tyre 47. Gjatë hulumtimit të rishikimeve kam vërejtur se audiencës kryesisht i kishte pëlqyer skenografia. Disa nga rishikuesit madje e vlerësuan si filmi më i mirë i gjiruar deri në atë kohë. Disa e quajtën version zhgënjyes të romanit. Dikush e vlerësoi si paraqitje e gjysmës së historisë. Disa rishikues pëlqyen aktorin Alfred Molina, disa tjerë nuk pëlqyen Sophie Marceau në rolin e Annës që sipas tyre dukej shumë e zbrazur. Disa tjerë pëlqejnë Annën por kritikojnë Sean Bean në rolin e Vronskit, etj.

Në vazhdim do ti paraqes mendimet e dhëna me shkrim të disave nga audiencia që janë regjistruar në këtë faqe (IMDb).

“Besnik i romanit dhe kënaqësi për sytë.” (i vlerësuar nëntë nga dhjetë yjet) piapia 15 mars 1999

“Vizualisht dhe dëgjimisht mahnitëse, por në përgjithësi një nga përshtatjet më të dobëta”
TheLittleSongbird 29 korrik 2015 (vlerësuar me 5 nga 10 yje gjithsej)


“Vrasës i mirë i kohës” (e vlerësuar me 6 nga 10 yje)
Merely 17 April 2001

“E shikova këtë sepse nuk e kisha lexuar kurrë librin dhe as nuk kisha parë ndonjë version teatrale. Në thelb ishte për t’u njohur me historinë (Edhe pse e dija fundin duke parë "Micki and Maude") Historia ishte e mrekullueshme, por ky film nuk ishte asgjë për të shkruar. Aktrimi ishte i tillë dhe nuk ndjeva asgjë për personazhet për shkak të kësaj. Megjithatë nuk më vjen keq që e pashë. Është një harxhues i mirë i kohës...nëse keni kohë...dhe nuk doni të lexoni një roman të Tolstoit...Kam dëgjuar se janë të gjatë.”

“Ia vlen ta shihni nëse nuk e lexoni romanin më parë”
sq8188 4 May 2003

“Derisa shumë detaje të romanit u lanë jashtë, regjisori Bernard Rose krijoi një interpretim elegant të klasikut rus. Bukuria e lezetshme dhe e rafinuar e Sofie Marceau është pikërisht lloji i gruas për të cilën janë shkruar romanet e shkëlqyera të dashurisë. Vendndodhja është autentike dhe skena të paharrueshme. Në përgjithësi, një ndryshim freskues nga shumë prej filmave të sotëm.”

Kjo ueb faqe përveç vlerësimeve të audiencës ka paraqitur përmes përmes grafikonit përqindjen e vlerësimeve të audiencës nga një deri në dhjetë yje.



Grafik1. Gjithashtu kjo faqe ka paraqitur edhe grafikonin e vlersimit sipas moshës.

3.2. *Përmbledhja e vlerësimeve të audiences:* Ashtu siç e kam elaboruar në këtë punim, në pritjen e një filmi nga audienca ndikojnë një sërë faktorësh objektiv dhe subjektiv. Përveç kësaj sipas teoritientëve të filmit, mënyra më e mirë e studimit të pritjes së një filmi është intervistimi i audiencës. Por në pamundësi të kësaj pasi ky film është shfaqur vite me parë, duke u mbështetur në ueb faqe të informimit sipas sondazheve të tyre, kam arritur në përfundim se filmi “Anna Karenina” (1997) nga audienca është pritur relativisht mirë. Në të dy rastet e votimit rezultati ka qenë përafërsisht i njëjtë. Mesatarja e mbi 2500 vlerësimeve të filmit nga përdoruesit e faqes Rotten Tomatoes, nga 0 deri në 100%, është 66% . Ndërsa sipas sondazhit të IMDb, ku kanë dhënë vlerësimin e tyre për këtë film mbi 5800 përdorues, nga 1 -10 yje, mesatarja e vlerësimit të filmit është 6.3 yje. Në tabelën e IMDb është paraqitur votimi edhe sipas moshës dhe gjinisë.

Siç vërehet në tabelën e mësipërme moshë e shikuesve që ka vlerësuar më së shumti filmin ka qenë ajo prej 18- 29 që e ka vlerësuar 6.4 pikë, ndërsa moshë nga 30 – 44 me 6.2 pikë, derisa shikuesit mbi moshën 45 vjeç e kanë vlerësuar me 6.1 pikë. Ndërsa sipas gjinisë, femrat e kanë vlerësuar me shumë se meshkujt. Ato e vlerësuan me 6.7 pikë, ndërsa meshkujt me 6.0 pikë. Siç shihet filmi është pritur relativisht mirë nga audienca. Sidomos nga ajo e moshës së re, dhe nga femrat.

3.3. *Kritika e filmit “Anna Karenina” (1997):* Filmi “Anna Karenina” (1997) si adaptim i romanit Anna Karenina nga Leo Tolstoi në vitin 1887. Produksion amerikan, u xhirua në Rusi me regji dhe skenar të Bernard Rose. Në rolet kryesore: Sophie Marceau and Sean Bean. Me kohëzgjatje 108 minuta. Ashtu si audienca edhe kritika ishte shumë e interesuar për këtë film. Shumë kritikë dhe teoritientë shkruan artikuj duke shprehur mendimet dhe kritikën e tyre për këtë film.

Në përgjithësi ky film u cilësua si filmi i parë perëndimor që u gjirua në rusin Post – Sovjetike. Rose filmin e fillon ndryshe nga libri dhe filmat tjera, me një skenë me imazhe spektakolare që mbështetin mendimet e Levinit që dëgjohe në sfond të pëshpëritura nga vet ai. “Frika se po vdes pa e shijuar dashurinë, është me e vështirë se ferri. Gjithashtu kjo ishte edhe frika e Ana Kareninës.” Kjo fjali që në fillim të filmit, ndërthur historinë e Levinit dhe Anës. E cila ndërlidhje përshkon tërë filmin, duke vulosur herë skenat e herë sekuencat kyçe të ngjarjes. Rose duke përdorë narracionin sikur ka dashur të eksplorojë specifika me të mëdha të cilat mbështetin imazhet në ekran, por kjo ka tjetërsuar konceptin e romanit.

Ai me këtë sikur ka penguar zhvillimin e linjës kryesore. Lidhje me këtë kishte kritika të shumta. Njëra ndër to ishte teoriticientja Irina Makoveeva e cila në punimin e saj: “Visualizing Anna Karenina” pos tjerash thekson se narracioni i futur në film nga Rose kishte prishur paralelizmin e ndërtuar në roman mes linjës së Anës dhe linjës së Levinit. “Megjithatë, përpjekja e tij origjinale për të përfshirë historinë e Anna Karenina-s brenda historisë së jetës së Tolstoit, prodhon një efekt të dyfishtë. Nga njëra anë, zgjeron përmbajtjen e filmit, por, nga ana tjetër, ngushton historinë e Anës.”¹⁴

Ajo ndër të tjera shprehet se ky film nuk ka arritur të nxjerrë në pah historinë e romanit të cilin e ka përshtatur. Sipas saj ky film është një përpjekje e ngatërruar për të ristrukturuar tekstin vizual të Anna Karenina. Makoveeva në punimin e saj shprehet se shpreson se adaptimet e ardhshme kinematografike të librit Anna Karenina do të provohen për të ndrequr mosbalancimin që ky ristrukturim ka krijuar në korpusin vizual për tu dhënë peshë të balancuar linjave të tregimit me theks të veçantë në linjat Anna - Vronsky dhe Levin - Kitty ashtu si Tolstoy në Novelë.

Ndërsa teoriticientja Stein në artikullin e saj “‘Anna Karenina’ Is Down for the Count / New, passionless take on Tolstoy classic”, lidhje me fillimin e këtij filmi shprehet: “Filmi fillon me Levinin. -- Anna shfaqet 15 minuta me vonë – dhe historia e tij ofron një xhirim filozofik që mungon në versionet e mëparshme të filmit, duke përfshirë atë të Greta Garbo”.¹⁵

Stein ndërsa duket se është neutral lidhje me fillimin e filmit, ai në këtë punim u fokusua në mungesën e pasionit tek aktoret. Stein kritikon lojën e aktore që sipas tij ishte shumë pa pasion. Ai shprehet se mungon kimia midis aktorëve në krahasim me romanin, madje kjo mungon edhe në mes të dy aktorëve kryesor Anna dhe Vronski. Sipas tij Tolstoi arsyei çdo veprim të Annës, ngaqë lidhjen e saj me Vronskin e veshi me aq pasion të madh, sa e la të kuptohej si e natyrshme kur ajo heq dorë nga gjithçka për të qenë me të. Derisa në film ky veprim nuk është arsyetuar si duhet.

“Është e vështirë të shihet se kjo Anna (Sophie Marceau) dhe Vronsky i saj (Sean Bean) kanë atë lloj dashurie për të cilën duhet të vdesin. Kur për herë të parë ia vunë sytë njëri – tjetrit në stacionin e trenit në Shen Petersburg, i vetmi avull mes tyre vjen nga motorri.”¹⁶

Sado që skenografia dhe atmosfera në stacion është shumë e besueshme, pengon shtypja e punëtorit të hekurudhës, është shumë e treguar. E pa menduar mirë nga regjisori duket kuadri subjektiv i Anës, që zgjat shumë. Derisa në roman Anna vetëm dëgjon nga i vëllai se është shtypur një punëtor nga treni , Rose ka zgjedhur që ajo duhet ta shoh, kështu që padashur të audienca përcjellë një shije tjetër të personalitetit të Anës. Përveç kësaj ky kuadër subjektiv merr konotacionin e një mesazhi të përmbledhur që pretendon të zbulon mesazhin përfundimtar, duke privuar nga tensioni ngjarjet që zhvillohen përgjatë rrëfimit.

¹⁴ Irina Makoveeva, “Visualizing Anna Karenina” (PhD dissertation, University of Pittsburgh, 2007), 98, http://d-scholarship.pitt.edu/8448/1/makovirina_etd2007.pdf .

¹⁵ Stein, Ruthe. “‘Anna Karenina’ Is Down for the Count / New, passionless take on Tolstoy classic” SFGATE, April 18, 1997. <https://www.sfgate.com/movies/article/FILM-REVIEW-Anna-Karenina-Is-Down-for-the-2845219.php> (Last accessed 13/03/2022).

¹⁶ Ibid.

Kritiku i filmit Chris Hicks: në punimin e tij “Film review: Leo Tolstoy’s Anna Karenina” pikërisht për këtë film shprehet: “Është e qartë që aspektet vizuale të detajuara të filmit janë pikat kryesore. Sa keq që ajo lloj vëmendje nuk iu kushtua edhe procesit të shkrimit të skenarit.”¹⁷ Përveç mungesës së kimisë dhe pasionit në mes të aktorëve Stein kritikon edhe rrjedhën e ngjarjes, ai shprehet se në këtë tregim nuk ka konflikt. Aktoret nuk janë bindes në rolet e tyre. Ndërsa theks të veçantë të kritikës i vë Sophie Marceau në rolin e Annës. Sipas tij ajo nuk është aspak konfliktuale, duke sjellë një anë të Annëd që duket njesoj e mërzitur si në dashuri me Vronskin ashtu edhe jashtë saj.

Por në kritikën e tij drejtuar aktorëve, përjashton Alfred Molinën në rolin e Levinit, për të cilin thotë se është aktori më i besueshëm në atë film dhe sipas tij ai aktor ka potencial të madh. “Papritur ajo hap sytë dhe të njëjtin moment fëmija fillon të qajë. Fytyra e Levinit shkon nga regjistrimi i shqetësimit ekstrem në gëzim. Kjo pjesë me në fund mund t’i jap Molinës – një aktor i mrekullueshëm që nuk ka marrë role të denja për aftësitë e tij – njohjen që meriton.”¹⁸ Kompozimi i kuadrove dhe skenografia janë realizuar në mënyrë perfekte. Dua të theksoj se duke u thelluar në këto kode gjatë gjithë rrjedhës së filmit, ju duket se ktheheni atje në të kaluarën e largët dhe bëheni pjesë të asaj kohe.

Skena e ballos është realizuar në mënyrë të përkryer, loja e mirë e aktorëve bashkë me kuadrin dhe skenografin prezantojnë këtë skenë të sintetizuar artistikisht. “I cilësuar si filmi i parë përendimor i realizuar tërësisht në Rusinë Post-Sovjetike, filmi ofron një tour të arkitekturës së Shën Petersburgut që të lë pa frymë, ...”¹⁹ Megjithatë, nga trajtimi i drejtpërdrejtë i temës së linjës kryesore, besueshmëria e ngjarjeve në film humbet. Rrjedhimisht, bëhet një transformim konstruktiv i aktorëve, pasi ata nuk kishin kohën dhe hapësirën e duhur filmike në dispozicion të tyre.

Lidhje me lojën e Levinit dhe aktorëve tjerë shprehet edhe teoritikuenti Stephen Holden. Ai në punimin e tij “A Post-Soviet Travelogue Of Pre-Soviet Frippery”. Sipas tij asnjë nga aktorët nuk kishte luajtur kënaqshëm rolin e përcaktuar apo të dhënë, madje ky ndryshe nga Stein nuk e vlerëson as lojën e Levinit. “(Alfred Molina është përfaqësuesi i Tolstoit, Constantin Levin dhe Mia Kirshner është gruaja e tij, Kitty) janë pak më shumë se kukulla të veshura mirë që nxjerrin dialog që ngjesh mendimin e autorit.”²⁰ Derisa Holden është kritik ndaj aktorëve, ai ngrit në pedestal skenografinë e këtij filmi duke theksuar se filmi të lë pa frymë në arkitekturën e Shën Petersburgut, në veçanti me skenat në pallatin dimëror të Katerinës së Madhe dhe Hermitazh. (Holden, 1997).

Holden sikur nuk arrin dot ta kuptojë sesi Rose-s i ka rrëshqitur pa vënë re fakti i lojës së ftohtë të aktoreve. Holden shprehet i hutuar edhe me disbalancin në mes të muzikës së zgjedhur që sipas tij ishte e mrekullueshme dhe lojës së aktorëve të cilët në këtë film jo vetëm se nuk bënë lojën si duhet, por ata nuk e ndien as dialogun që thanë. Në dialogun e Annës me të shoqin në karrocë derisa ktheheshin nga garat, ajo shfaqet paksa arrogante. Ndryshe nga romani ajo nuk ndjen keqardhje, madje me të zbritur nga karroca, mënyra e ecjes së saj drejt vilës është mëse krenare, gjë që nuk përkon me përcjellje të muzikës melodramatike. Ashtu siç thekson Stephen Holden “Por nëse Z.Rose e kupton fuqinë e muzikës romantike për t’i bërë zemrat e shikuesve të filmit të rrëqethin (ai drejtoi biografinë e Beethoven “Immortal Beloved”), ‘Anna Karenina’ e tij është në mënyrë kurioze dhe katastrofike pa pasion.”²¹

¹⁷ Hicks, C. (1997, June 21). Film review: Leo Tolstoy's Anna Karenina. *Deseret News* .

¹⁸ Ibid.

¹⁹ Holden, Stephen. “A Post-Soviet Travelogue of Pre-Soviet Frippery.” *The New York Times*, April 4, 1997. <https://www.nytimes.com/1997/04/04/movies/a-post-soviet-travelogue-of-pre-soviet-frippery.html>.

²⁰ Holden, Stephen. “A Post-Soviet Travelogue Of Pre-Soviet Frippery” *The New York Times*, April 04, 1997. <https://archive.nytimes.com/www.nytimes.com/library/film/anna-film-review.html> (Last accessed 29/05/2024)

²¹ Ibid.

Kritiku Angie Errigo në artikullin e tij “Anna Karenina Review” vë në pah paralelizmin mes historis së Annes dhe asaj të Levinit që Rose u ka dhënë në film, madje sipas tij, Rose më shumë paraqet historinë e dashurisë së Levinit dhe Kitit sesa historinë e lidhjes mes Annës dhe Vronskit. “Njeriu është shumë më i angazhuar në rrjedhën e dashurisë së Levinit për kunatën e Anës Princeshën Kitty (Kershner) sesa në udhëtimin historik të Annës dhe Vronskit të dëshpëruar por të dobët nga epshi në shikim të parë në lodhje, dëshpërim dhe neveri.”²²

Errigo përveç tjerash, kritikon edhe ekipin apo kastingun e aktorëve, i cili është ndërkombëtarë. Sipas tij ky ishte një problem tjetër që shkoi në disavantazh të filmit, ngaqë sipas tij gjithë kjo vuri në pah sjellje dhe thekse të ndryshme të aktorëve, varësisht prej përkatësisë nacionale të tyre. E tërë kjo sipas Errigo përmblyti besimin se historia po ndodh në një vend apo rreth aristokrat të Rusisë ku aktoret duhej të kishin lidhje gjaku.

“Ekipi ndërkombëtar ofron një gamë sjelljesh dhe theksesh dhe këto kombinohen për të përmblytur përshtypjen e lidhjes së ngushtë të gjakut dhe kastës që i bëri aristokratët e Rusisë Perandorake një rracë kaq të rrallë, të rregulluar në mënyrë të ngurtë dhe përfundimisht të dënuar.”²³ Edhe teoriticianti Chris Hicks në punimin e tij “Film Review: Leo Tolstoy’s Anna Karenina” Në filmin “Anna Karenina” (1997) kritikon mungesën e kimisë tek aktoret, me theks të veçantë tek Anna dhe Vronski. Sipas tij, kimia e aktorëve do të duhej të ishte thelbësore në një film si ky. Ai madje pakënaqësinë e tij e shpreh në formë të një thirrje që i bënte audiencës: “Këtu ka ende kënaqësi, nëse mund ta pranoni një përshtatje të Tolstoit si një telenovelë e cekët.”²⁴

Ai ndër të tjera thekson se historia e Levinit paraqitet shumë më interesante sesa ajo e Annës. Hicks mendon se kjo mund të ketë frustruar audiencën. Ndërsa lidhje me Molinën në rolin e Levinit ai shprehet: “Thyerja e zemrës dhe gëzimi i tij eventual, janë përcjellë aq bindshëm, sa duket se është në një film tjetër.”²⁵

Ndërsa Roger Ebert në punimin e tij “Leo Tolstoy’s Anna Karenina” shpreh hapur pakënaqësinë në lidhje me atë sesi ka adaptuar Rose historinë nga romani Anna Karenina: “Ka shumë më tepër në historinë e Tolstoit - por jo në këtë përshtatje pa gjak dhe të cekët.”²⁶ Ebert derisa paraqet pëlqimin e tij për muzikën dhe skenografinë e këtij filmi, këtë sikur nuk balancon dot me lojën e aktorëve dhe rrjedhën e historisë, që sipas tij duket t’i këtë rrëshqitur nga dora regjisorit Rose. “Këtu, duke xhiruar në vende të bukura, ai duket se ka humbur gjurmët e personazheve të tij.”²⁷ Ebert në punimin e tij “Leo Tolstoy’s Anna Karenina” ngrit çështjen e adaptimve me ç’rast ndodh devijimi i personazhit. Ai ndër të tjera thekson se nuk kishin munguar tregimet për gratë e pa kënaqura në martesë siç ishte rasti i Anna Karenina, por ishte talenti i Tolstoit që ketë histori e nxjerrë të jashtëzakonshme. “... duke u fokusuar në historinë, e cila pa urtësinë e Tolstoit, është një çështje e zymtë dhe melodramatike.”²⁸

Derisa në roman Anna merr morfinë që të mund të qetësohet, Rose ka paraqitur se është morfina ajo që e shkatërron. Halucinacionet e saj dhe jostabiliteti mendor i paraqitur në film, lënë te audienca një shije zhgënjimi, pasi duket se ajo po zhytet ngadalë në çmenduri duke u larguar shumë nga personazhi që paraqitet në roman.

²² Errigo, Angie. “Anna Karenina” Empire, January 01, 2000. <https://www.empireonline.com/movies/reviews/anna-karenina-review/> (Last accessed 14/03/2022)

²³ Ibid.

²⁴ Hicks, Chris. “Film review: Leo Tolstoy’s Anna Karenina” Deseret News. June 21, 1997. <https://www.deseret.com/1997/6/21/20087968/film-review-leo-tolstoy-s-anna-karenina> (Last accessed 15/12/2021)

²⁵ Ibid.

²⁶ Ebert, Roger. “Leo Tolstoy’s Anna Karenina” RogerEbert.com April 18, 1997. <https://www.rogerebert.com/reviews/leo-tolstoys-anna-karenina-1997> (Last accessed 11/03/2022)

²⁷ Ibid.

²⁸ Ibid.

Roger Ebert në punimin e tij: “Leo Tolstoy’s Anna Karenina” ndër të tjera thekson: “Sfida e cilitdo adaptues të “Anna Karenina” është që ta bëjë Annën simpatike, pavarësisht sjelljes së saj të keqe.”²⁹ Fatkeqësisht në këtë film nuk tregohet por madje personazhi i saj, sa shkon e bëhet më i lodhshëm për mos të thënë i urreyer. Skenaristi në këtë rast regjisori duke kaluar plotësisht pjesën e gjashtë të librit ka lënë jashtë plotësisht jetën e Anës dhe Vronskit në fshatë. Kjo do të kishte dhënë kohë të mjaftueshme ndryshimit natyral të dy personazheve kryesorë.

Rose duke mos paraqitur shkuarjen e Annës në opera, stories në film i jep një konotacion tjetër nga ajo në roman: Anna përbuzet së pari nga Vronski e pastaj nga shoqëria. Skena kur Vronski përgatitet të shkon në opera dhe pa fare keqardhje i thotë asaj se nuk mund ta shoqërojë, Anna zhgënjën audiencën me përulësinë e saj në këtë skenë. Siç thekson Ruth Stein: “Është e vështirë që kjo Anna (Sophie Marceau) dhe Vronsky i saj (Sean Bean) kanë atë llojë dashurie për të cilën duhet të vdesin”³⁰

Ndërsa Robert S. Grosse në punimin e tij “Anna Karenina: A Cinematic Journey on the Silver Screen from 1927 to 2012.” fokusohet në risitë që ka sjellë Rose në këtë film për ndryshim nga filmat e më hershëm. Sipas tij, ky ishte një adaptim shumë interesant i romanit. “Ishte e çartë se Rose kishte marr hua disa ide nga filmi 1948 me Vivien Leigh, por gjithashtu shtoi disa elemente të reja që nuk ishin të pranishme në filmat e mëparshëm. Për shembull historia në këtë film u tregua nga Leo Tolstoi nëpërmjet karakterit të Konstadin Levinit.”³¹

Ndërsa teoriticienti Russell Smith në punimin e tij “Leo Tolstoy’s Anna Karenina.” (1997) lavdëron vizionin e regjisorit Rose. Sipas Smith, Rose ka arritur deri diku në realizimin e synimeve të autorit duke shpëtuar pasazhe kryesore të narracionit nga Levini, që sipas tij është egoja e Tolstoit në histori. Smith gjithashtu thekson se Rose ka arritur të nxjerr në pah skenat me të rëndësishme të historisë. “Ai gjithashtu tregon një sy të mprehtë për skenat kryesore ku romani gjen fuqi simbolike në bukurinë e zyrtë dimërore të Ruisë.”³²

Smith nuk vë në dyshim talentin dhe qëllimet e mira të Rose, ai madje mundohet ta arsyetoj faktin që nuk ka arrit t’i zhvilloj dy personazhet kryesor. Smith thekson Rose pengohet nga i njëjti problem me të cilin sipas tij ishin përballur të gjithë adaptuesit e më hershëm të këtij romani. Sipas tij ashtu si regjisorët tjerë edhe Rose nuk i ka shpëtuar faktit të mos shfaqjes së Annës dhe Vronskit antipatik. Smith pasi pajtohet se në këtë film kishte dështime në lojën e aktorëve, megjithatë ai i bënë thirrje teoriticientëve dhe audiencës në përgjithësi që mos ta kryqëzojnë regjisorin Rose “Vëreni këtë si një dështim fisnik Shumë tjerë kanë vrapuar drejt Tolstoit të madh dhe kanë dështuar. Dhe ndonjëherë guximi i pastër meriton respekt, edhe nëse nuk shpërblehet plotësisht.”³³

Ndërsa teoriticienti Todd McCarthy në punimin e tij “Leo Tolstoy’s Anna Karenina.” rreth filmit (1997) shprehet se edhe ky film ashtu si filmat e më hershëm kishte arritë ta nxjerrë në pah në menyrë të kënaqshme historinë. Dallimi qëndron në faktin që është versioni i parë përendimor , i gjiruar në tokën ruse Sipas McCarthy ky film ishte një interpretim i pa pasion i stilit klasik.

²⁹ Ebert, R. (1997, April 18). *Leo Tolstoy's Anna Karenina*. Gjetur në RogerEbert.com: <https://www.rogerebert.com/reviews/leo-tolstoys-anna-karenina-1997>

³⁰ Stein, Ruthe. “‘Anna Karenina’ Is down for the Count / New, Passionless Take on Tolstoy Classic.” SFGATE, April 18, 1997. <https://www.sfgate.com/movies/article/FILM-REVIEW-Anna-Karenina-Is-Down-for-the-2845219.php>.

³¹ Grosse, Robert S. “Anna Karenina: A Cinematic Journey on the Silver Screen from 1927 to 2012.” *Issues Impacting All of Us*, March 6, 2013. <http://heidegggerm1.blogspot.com/2013/03/anna-karenina-cinematic-journey-on.html> (Last accessed 10/03/2022)

³² Smith, Russell “Leo Tolstoy’s Anna Karenina.” *The Austin Chronicle*, May 23, 1997. <https://www.austinchronicle.com/events/film/1997-05-23/142485/> (Last accessed 11/03/2022)

³³ Ibid.

“Nëse do të ribëni një histori aq shpesh të filmuar si "Anna Karenina", do të kishit më mirë një arsye të mirë për ta bërë këtë, dhe asnjë nuk është e dukshme në këtë tregim emocionalisht inert të romanit të madh të Tolstoit për dashurinë dhe pasojat e tradhtisë.”³⁴

3.4. Përmbledhja e vlerësimit të kritikës: Filmi mori një përgjigje të përzier nga kritika. Në përgjithësi filmi mori vlerësim për tërheqjen e tij vizuale dhe performanca të caktuara, por kritika për ekzekutimin e tij narrativ dhe rezonancën emocionale. Shumë kritikë vlerësuan stilin vizual të filmit, duke theksuar skenografin dhe dizajnin e përpunuar të prodhimit. Estetika e filmit u shqua për kapjen e madhështisë dhe begatisë së aristokracisë ruse. Disa kritikë mendonin se ritmi i filmit ishte i pabarabartë, me disa pjesë që zvarriteshin ndërsa të tjerët ndjeheshin të nxituar.

Disa kritikë mendonin se ritmi i filmit ishte i pabarabartë, me disa pjesë që zvarriteshin ndërsa të tjerët ndjeheshin të nxituar. Kishte gjithashtu kritika për besnikërinë e adaptimit ndaj romanit të Tolstoit, me disa që argumentuan se filmi nuk arriti të kapte thellësinë dhe kompleksitetin e materialit burimor. Një numër recensentësh komentuan se filmit i mungonte intensiteti emocional dhe thellësia e zhvillimit të personazheve të nevojshme për të përfshirë plotësisht audiencën me historinë tragjike të Anës. Kjo u pa si një mangësi domethënëse duke pasur parasysh peizazhin e pasur emocional të romanit. Anna Karenina" e Bernard Rose u admirua për bukurinë e saj vizuale dhe disa performanca të forta, ajo u kritikua gjithashtu për mos kapjen e plotë të thellësisë emocionale dhe tematike të romanit të Tolstoit.

4. Përfundimi

Ashtu siç e kam elaboruar në këtë punim, në pritjen e një filmi nga audienca ndikojnë një sërë faktorësh objektiv dhe subjektiv. Natyrisht se edhe kritika ka ndikim në pritjen e një filmi nga audienca Duhet pasur parasysh se studiuesi asnjëherë nuk mund të bazohet në opinionet e një kritiku, ngaqë ato mund të mos përfaqësojnë një pjesë të audiencës. Për të krijuar një përshtypje sesi mund të jetë pritur një film klasikë duhet të përdoret material nga shtypi, industria e filmit etj. Përveç kësaj sipas teoricientëve të filmit, mënyra me e mirë e studimit të pritjes së një filmi është intervistimi i audiencës.

Por në pamundësi të kësaj kur filmi është shfaqur vite me parë, siç është rasti me filmin Anna Karenina atëherë duhet të mbështetemi në media elektronike dhe në ueb faqe të informimit. Sipas sondazheve të mbledhura, kam arritur në përfundim se filmi “Anna Karenina” (1997) nga audienca është pritur relativisht mirë. Në të dy rastet e votimit rezultati ka qenë përafërsisht i njëjtë. Ndërsa nga kritikët filmi mori vlerësime të ndryshme. Në saj të grumbullimit të rishikimeve filmi ka marrë një vlerësim mesatar, duke reflektuar mendimet e ndara midis kritikëve.

"Anna Karenina" e Bernard Rose u admirua për bukurinë e saj vizuale dhe disa performanca të forta, ndërsa u kritikua gjithashtu për mos kapjen e plotë të thellësisë emocionale dhe tematike të romanit të Tolstoit. Kritika mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në pritjen e një filmi nga audienca. Vlerësimet nga kritikët shpesh formojnë zhurmën fillestare rreth një filmi. Vlerësimet pozitive mund të krijojnë emocione dhe pritje, duke inkurajuar audiencën për të parë filmin, ndërsa kritikën negative mund të zbehin entuziazmin dhe të pengojnë shikuesit e mundshëm.

Shumë anëtarë të audiencës mbështeten te kritikët si burime të besuara për rekomandime. Disa kritikë gjenerojnë audiencë, kështuqë opinionet e tyre mund të kenë peshë të konsiderueshme me audiencën e tyre, duke udhëhequr zgjedhjet e tyre të filmit.

³⁴ McCarthy, Todd “Leo Tolstoy’s Anna Karenina.” Variety, May 31, 1997. <https://variety.com/1997/film/review/s/leo-tolstoy-s-anna-karenina-1117436671/> (Last accessed 14/03/2022)

Edhe pse vlerësimet kritike kanë ndikim tek audiencia, ato janë një nga shumë faktorë që formësojnë pritjen e audiencës. Mesazhet e koduara përmbajnë shenja dhe simbole të përbashkëta për të gjithë spektatorët. Leximi i mesazheve nga audiencia bëhet në bazë të ndërveprimit të tyre me tekstet në kontekste specifike për të krijuar kuptime. Pra mesazhet e koduara natyrisht që ndikojnë në pritjen e një filmi nga audiencia në varësi të asaj sesa arrin audiencia t'i deshifroj ato. Kuptimi i mesazhit nga audiencia, mund të ndryshoj, sipas kontestit të tyre shoqëror, në mënyrën si ata e shohin të përshtatshëm. Mesazhi i koduar deshifrohet nga audiencia në bazë të njohurive që posedon ajo audiencë, sipas studiuesve shpesh audiencia deshifron apo dekodon mesazhin në mënyra të ndryshme, dhe jo në mënyrën si ka menduar prodhuesi. Në këtë rast edhe prodhuesi duhet të jetë i vëmendshëm që mos të përcjell mesazhe që nuk dekodohen lehtë nga audiencia.

Ndërsa sa i përket pritjes para-ekzistuese të audiencës të formuara nga marketingu apo veprat e mëparshme, në pritjen dhe kritikën e një filmi ka një ndikim të madh. Kur filmi është adaptim i një romani siç është rasti me filmin në fjalë, ndryshe do të jetë pritja nga audiencia që kishin lexuar romanin me parë, dhe ndryshe nga ata që nuk e kanë lexuar. Por duke u bazuar në bujën që kishte bërë ky roman, duke u përkthyer në të gjitha gjuhët e botës, i cili edhe sot lexohet me endje, mund të ketë përqindje të vogël të audiencës që nuk e kanë lexuar romanin me parë.

Gjatë këtij analizimi kam vërejtur se kur filmi është adaptim i një vepre klasike kjo ka ndikim edhe te producentët, skenaristët dhe regjisorët, por jo në kuptimin pozitiv që ata të jenë me të kujdesshëm gjatë procesit të adaptimit, por në sensin negativ për të lënë shumë gjëra si të nënkuptuara nga audiencia me paragjykimin se ato i kanë të njohura nga romani. Në rastin konkret disa shqyrtues nuk pëlqyen Sophie Marceau në rolin e Annës që sipas tyre dukej shumë e zbrazur. Disa tjerë pëlqejn Annën por kritikojn Sean Bean në rolin e Vronskit, etj. Disa shprehen se pëlqejnë historinë e Tolstoit, por sipas tyre kjo nuk ishte një përshtatje e shkëlqyer e saj. Pra siç shihet pritjet para- ekzistuese dhe reklamat kanë një ndikim të madh si të kritikët ashtu edhe të audiencia, posaçërisht veprat që konsiderohen si universale, ato mund të përcojnë mesazhin e njëjtë apo të ndikojnë njëjtë tek lexuesit e të gjitha epokave.

Referencat

- [1]. Hans Robert Jauss, *Toward an Aesthetic of Reception*. Translated by Timothy Bahti. (Minneapolis: University of Minnesota Press, 1982), 170.
- [2]. Hans Robert Jauss, *Toward an Aesthetic of Reception*. Translated by Timothy Bahti. (Minneapolis: University of Minnesota Press, 1982), 175.
- [3]. Reception Theory: Methodology.” Film Reference. <http://www.filmreference.com/encyclopedia/Independent-Film-Road-Movies/Reception-Theory-METHODOLOGY.html> (last accessed 12/02/ 2022)
- [4]. Ibid
- [5]. Makoveeva, Irina. “Cinematic Adaptations of Anna Karenina.” *Studies in Slavic Cultures*, no.2 (2001): 2.
- [6]. Staiger, Janet. “Film, Reception, and Cultural Studies” *The Centennial Review* 36, No.1 (1992): 94.
- [7]. Stuart Hall, “Encoding and Decoding In The Television Discourse”, *Council & The Centre for Mass Communication Research, University of Leicester*, (1973): 3.
- [8]. David Morley and Charlotte Brunson. *The Nationwide Television Studies* (London: Routledge, 2005), 134.
- [9]. Shohat, Ella, and Robert Stam. *Unthinking Eurocentrism: Multiculturalism and the Media*. 2nd ed. New York: Routledge, 2014, 353.
- [10]. Ibid, 22.
- [11]. Ibid, 353.
- [12]. Stuart Hall, “Encoding and Decoding In The Television Discourse”, *Council & The Centre for Mass Communication Research, University of Leicester*, (1973): 12.
- [13]. Stuart Hall, “Encoding and Decoding In The Television Discourse”, *Council & The Centre for Mass Communication Research, University of Leicester*, (1973): 14.
- [14]. Irina Makoveeva, “Visualizing Anna Karenina” (PhD dissertation, University of Pittsburgh, 2007), 98, http://d-scholarship.pitt.edu/8448/1/makovirina_etd2007.pdf .

- [15]. Stein, Ruthe. “‘Anna Karenina’ Is Down for the Count / New, passionless take on Tolstoy classic” SFGATE, April 18, 1997. <https://www.sfgate.com/movies/article/FILM-REVIEW-Anna-Karenina-Is-Down-for-the-2845219.php> (Last accessed 13/03/2022).
- [16]. Ibid.
- [17]. Hicks, C. (1997, June 21). Film review: Leo Tolstoy’s Anna Karenina. Deseret News .
- [18]. Ibid.
- [19]. Holden, Stephen. “A Post-Soviet Travelogue of Pre-Soviet Frrippery.” The New York Times, April 4, 1997. <https://www.nytimes.com/1997/04/04/movies/a-post-soviet-travelogue-of-pre-soviet-frippery.html>.
- [20]. Holden, Stephen. “A Post-Soviet Travelogue Of Pre-Soviet Frrippery” The New York Times, April 04, 1997. <https://archive.nytimes.com/www.nytimes.com/library/film/anna-film-review.html> (Last accessed 29/05/2024)
- [21]. Ibid.
- [22]. Errigo, Angie. “Anna Karenina” Empire, January 01, 2000. <https://www.empireonline.com/movies/revIEWS/anna-karenina-review/> (Last accessed 14/03/2022)
- [23]. Ibid.
- [24]. Hicks, Chris. “Film review: Leo Tolstoy’s Anna Karenina” Deseret News. June 21, 1997. <https://www.deseret.com/1997/6/21/20087968/film-review-leo-tolstoy-s-anna-karenina> (Last accessed 15/12/2021)
- [25]. Ibid.
- [26]. Ebert, Roger. “Leo Tolstoy’s Anna Karenina” RogerEbert.com April 18, 1997. <https://www.rogerebert.com/reviews/leo-tolstoys-anna-karenina-1997> (Last accessed 11/03/2022)
- [27]. Ibid.
- [28]. Ibid.
- [29]. Ebert, R. (1997, April 18). Leo Tolstoy’s Anna Karenina. Gjetur në RogerEbert.com: <https://www.rogerebert.com/reviews/leo-tolstoys-anna-karenina-1997>
- [30]. Stein, Ruthe. “‘Anna Karenina’ Is down for the Count / New, Passionless Take on Tolstoy Classic.” SFGATE, April 18, 1997. <https://www.sfgate.com/movies/article/FILM-REVIEW-Anna-Karenina-Is-Down-for-the-2845219.php>.
- [31]. Grosse, Robert S. “Anna Karenina: A Cinematic Journey on the Silver Screen from 1927 to 2012.” Issues Impacting All of Us, March 6, 2013. <http://heideggerm1.blogspot.com/2013/03/anna-karenina-cinematic-journey-on.html> (Last accessed 10/03/2022)
- [32]. Smith, Russell “Leo Tolstoy’s Anna Karenina.” The Austin Chronicle, May 23, 1997. <https://www.austinchronicle.com/events/film/1997-05-23/142485/> (Last accessed 11/03/2022)
- [33]. Ibid.
- [34]. McCarthy, Todd “Leo Tolstoy’s Anna Karenina.” Variety, May 31, 1997. <https://variety.com/1997/film/reviews/leo-tolstoy-s-anna-karenina-1117436671/> (Last accessed 14/03/2022)